

Nr: 03-2/2
Shkup: 26.01.2022

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 3 paragrafi (2) i Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 26.01.2022, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e shqyrtoi Propozim - Programin për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë sociale për vitin 2022 të dorëzuar nga Ministria e Ekonomisë dhe për sa i përket qëllimit të tij, vlerëson se përmban masa që përbëjnë ndihma shtetërore, por për të njëjtën nuk zbatohet Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore sipas nenin 3 paragrafi (2), sepse ndihma e tillë jepet në fushën e bujqësisë dhe peshkimit, d.m.th. në industrinë përkatëse të prodhimit.

Sipas Klasifikimit Nacional të Veprimtarive - NKD rev 2 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 147/08 dhe 4/13), sektori i industrisë përpunuese përfshin: prodhimin e produkteve ushqimore, përpunimin dhe konservimin e mishit dhe prodhimin e produkteve të mishit, përpunimin dhe konservimin e peshkut, molusqeve dhe guaskave, përpunimin dhe konservimin e frutave dhe perimeve, prodhimin e vajrave dhe yndyrave bimore dhe shtazore, prodhimin e produkteve të qumështit, prodhimin e produkteve të mullirit, niseshtesë dhe produktet e nishestës , prodhimin e produkteve të furrës dhe makaronave , prodhimin e produkteve të tjera ushqimore (sheqer, kakao, çokollata dhe produkte ëmbëlsirash, përpunimin e çajit dhe kafesë, prodhimin e erëzave dhe shtojcave të tjerë, prodhimin e ushqimeve dhe shujtave të gatshme etj.), prodhimin e ushqimeve të gatshme për kafshë.

Propozim - Programi i dorëzuar për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese për vitin 2022 me dy fushat e përmbajtura (fusha A. Zbatimi i politikës industriale dhe fusha B. Përgjegjësia sociale) përmban masa për mbështetjen e konkurrencës së subjekteve afariste, por duke qenë se qëllimi i këtyre fondeve është të ndihmojë kompanitë në industrinë e përpunimit, kjo ndihmë bie në nenin 3 paragrafi (2) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, për të cilat fusha nuk zbatohet ky ligj. Në bazë të nenit 69 paragrafi (4) të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësive Evropiane dhe shteteve anëtare të saj ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 28/01) dispozitat për ndihmën shtetërore nuk zbatohen për produktet bujqësore dhe të peshkut, ku këto produkte janë të gjitha produktet që janë të theksuara në Kapitujt 1 deri në 24 të Nomenklaturës së Kombinuar dhe produktet të theksuara në Aneksin I, paragrafi 1, (ii), të Marrëveshjes për Bujqësinë (GATT 1994). Rrjedhimisht, Ministria e Ekonomisë nuk është e detyruar të veprojë në përputhje me nenin 13 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, gjegjësisht për Propozim-Programin e lartpërmendur dhe nuk është e detyruar të dorëzojë njoftim për dhënien e planifikuar të ndihmës në përputhje me Dekretin për mënyrën dhe procedurën e parashtrimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 142/11).

Shuma e përgjithshme e mjeteve për realizimin e këtij Propozim-Programi parashikohet të jetë 13.900.000 denarë, përkatësisht 13.100.000 denarë për zonën A. Zbatimi i politikës industriale dhe 800.000 denarë për zonën B. Përgjegjësi sociale.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски